

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në Departamentin e Inxhinierisë Informatike si më poshtë:

A. Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektorë” pranë Departamentit të Inxhinierisë Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit për lëndë të grupit kërkimor mësimor “Arkitektura, Sistemet dhe Rrjeta Kompjuterike”, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor + Master i Shkencave) të studimeve në fushën e Inxhinierisë Informatike;

2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave ≥ 8.0 ;

2.1 Notë 9 ose 10 në lëndët respektive ku do të angazhohen (Bachelor në Inxhinieri Informatike dhe Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike), përkatësisht: Sistemet Operative, Arkitektura e Kompjuterave, Siguria Kibernetike;

3. Të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës Angleze;

4. Preferohet të kenë botime të artikujve në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN, si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings me kod ISBN;

5. Të ketë eksperiencë pune në mësimdhënie në Universitet (me kohë të plotë ose pjesshme);

6. Të ketë dy rekomandime nga personeli akademik i FTI, UPT me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DII, FTI;

7. Preferohet të zotërojnë certifikime në fushën e sigurisë kibernetike dhe rrjetave.

B. Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektorë” pranë Departamentit të Inxhinierisë Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit për lëndë të grupit kërkimor mësimor “Inxhinieri Softi, Gjuhëve të Programimit dhe Bazave të të dhënave”, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor + Master i Shkencave) të studimeve në fushën e Inxhinierisë Informatike;

2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave ≥ 8.0 ;

2.1 Notë 9 ose 10 në lëndët respektive ku do të angazhohen (Bachelor në Inxhinieri Informatike dhe Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike), përkatësisht: Programim i Orientuar nga Objekti, Algoritmik dhe Programim i Avancuar, Inxhinieri Software dhe Programim i Avancuar.

3. Të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës Angleze dhe gjuhës Franceze B1 (në kuadër të bashkëpunimit me UTC për diplomën Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike);

4. Preferohet të kenë botime të artikujve në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN, si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings me kod ISBN;
5. Të ketë eksperiencë pune në mësimdhënie në Universitet (me kohë të plotë ose pjesshme);
6. Të ketë dy rekomandime nga personeli akademik i FTI, UPT me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DII, FTI;
7. Preferohet të zotërojnë certifikime në fushën e programimit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 18.09.2026 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.